

Përfshirja e lëndëve të KSP-së në programet arsimore në nivel universiteti: studim krahasues rasti i Portugalisë rasti i Spanjës

Susana Jorge
Isabel Brusca
4 dhjetor 2024



CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform




PULSAR 

Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Përmbajtja



2


- Konteksti
- Shqyrtim i literaturës
- Studim krahasues
 - Objektivat dhe metodika e studimit
 - Konstatimet e studimit
- Rasti i Portugalisë
- Rasti i Spanjës

Konteksti



3

- **Pikënisja:** Raund i parashikueshëm i reformave të kontabilitetit në sektorin publik të zbatuara në mbarë Evropën
- Reformat e kontabilitetit në sektorin publik i karakterizojnë vendet evropiane prej futjes së menaxhimit të ri publik (Hood, 1991, 1995) dhe ende gjallërojnë debat
- Reforma e SEKSP-ve – por nuk është ende e qartë *kur* dhe *si* do të ndiqet një paketë standardesh të kontabilitetit në të gjithë Evropën



•Sistemet e kontabilitetit në sektorin publik po u nënshtrohen ndryshimeve të thella dhe kjo kërkon gatishmërinë e një personeli të aftë, me dije adekuate të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe të veçantive të sektorit publik

Shqyrtim i literaturës (1)



4


- Problemet në lidhje me arsimin në sektorin publik nuk janë të reja ... Por puna kërkimore është përqendruar kryesisht në SHBA
- Mospërputhje e madhe mes rritjes së kompleksitetit të kontabilitetit shtetëror dhe mbulimit të siguruar nga programet e fakulteteve ekonomike, ku kontabiliteti i sektorit publik është thuajse i lënë pas dore në kurset akademike (Fox, 1977)
- Interes i kufizuar nga universitet për të ofruar kurse për sektorin publik, për shkak të mungesës së burimeve financiare apo mungesës së trupave pedagogjike të kualifikuara për mbajtjen e leksioneve (Egenolf & Willis, 1983; Epps & Brown, 1992)
- Tërheqje e kufizuar e studentëve nga kontabiliteti shtetëror (Beights, 1954; Engstrom, 1979; Shivaswamy and Hanks, 1985), me një efekt të mundshëm qarkor (Martin and Waymire, 2017)
- Mbulim i kufizuar i çështjeve të KSP-së në programet MPA/MPP në Australi, Zelandë të Re, Kanada, Britani e Madhe dhe SHBA (Pal & Clark, 2016), dhe Evropë (Karatzimas et al., pritet publikimi)

Shqyrtim i literaturës (2)



5

- “Arsimi kontabël është në mes të një reforme që synon t’u japë zgjidhje mangësive të perceptuara lidhur me mbizotërimin e një pikëpamjeje të ngushtë funksionaliste të kësaj disipline” (Boyce, 2004:569)
- Nevoja për ofrimin e arsimit kontabël në mënyrë koherente me **ndryshimet teknologjike dhe globalizimin** (Albrecht dhe Sack, 2000; Howieson, 2003)



Nevoja për të vlerësuar gjendjen e arsimit në KSP në disa vende evropiane

studim krahasues



6

Adam, B., Brusca, I., Caperchione, E., Heiling, J., Jorge, S. M. F., & Manes Rossi, F. (2020). A po i përgatitin studentët për SNKSP-të institucionet e arsimit të lartë në Evropë?. *International Journal of Public Sector Management*, 33(2/3), 363-378.

▪ Objektivat:


- Vlerësimi i situatës aktuale të arsimit për kontabilitetin e sektorit publik në institucionet e arsimit të lartë në GER, I, PT dhe ES dhe
- Kryerja e një analize nëse institucionet e arsimit të lartë në këto vende janë gati për kërkesën e parashikueshme të madhe për personel të aftë në administratat publike

▪ Fushëveprimi:

- Universitetet, shkollat politeknike dhe universitetet e shkencave të aplikuara në Gjermani, Itali, Portugali dhe Spanjë

○ Metodika:

- Pyetësorë të dërguar në prill-maj 2017 universiteteve gjermane dhe në nëntor 2017 universiteteve në Itali Portugali dhe Spanjë



•Për të nxjerrë rezultate krahasuese për gjendjen e arsimit në fushëm e MFP-së, sidomos të KSP-së

Konstatimet e studimit (1)



- Programet studimore të menaxhimit të financave publike në ciklin e parë ose të dytë të universitetit:

	Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
Shkalla totale e përgjigjes	46,6%			
Shkalla e përgjigjes sipas vendeve	24,3%	68,2%	72,2%	56%
Nr. i pyetësorëve të dërguar	74	44	18	25
Përgjigje gjithsej	18	30	13	14

	Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
Programe studimore të MFP-së në ciklin e parë ose të dytë të universitetit:	0%	13,3%	23,1%	50%
Numri mesatar i studentë në vit	0	10-25	40-150	15-100

Konstatimet e studimit (2)



8

- Shumica e atyre që u përgjigjën konfirmuar një ose më shumë kurse/seminare për MFP-në (mesatarisht 76%)
- Numri i studentëve për kurs/seminar në vit:

Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
66,6%	83,3%	69,2%	78,5%

	0-40	41-80	81-120	121+
Numri total i kurseve	31	14	4	8
Gjermania	41,6%	33,3%	8,3%	16,6%
Italia	56%	16%	8%	20%
Portugalia	66,7%	22,2%	0%	11,1%
Spanja	54,5%	36,3%	9,1%	0%

Konstatimet e studimit (3)



9

- Në shumicën e rasteve, këto kurse/seminare janë fakultative dhe jo të detyrueshme (mesatarisht 60%)
- SNKSP-të bëjnë pjesë në kurse/seminare në mesatarisht 46% të rasteve kur ofrohen kurse për MFP-në

	Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
Të detyrueshme	0%	68%	33,3%	27,3%
Fakultative	100%	32%	66,7%	72,7%

Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
45,5%	58,3%	77,8%	0%

(personat që janë përgjigjur mund t'i kenë ngatërruar kurset me seminaret)

Konstatimet e studimit (4)



10

- Në rastet kur nuk ofrohen kurse/seminare për MFP-në, elemente të MFP-së përfshihen në 78% të leksioneve/seminareve për administratën publike/menaxhimin publik
- Në 91% të përgjigjeve, studentët mund ta bëjnë tezën e diplomës për një temë të MFP-së (në veçanti KSP)

Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
66,6%	60%	60%	33,3%

Gjermania	Italia	Portugalia	Spanja
94,4%	93,1%	92,3%	85,7%

Analizë krahasuese



11

- Në të gjitha vendet, në shumicën e rasteve, ofrohen kurse/seminare të veçanta për MFP në diplomë biznesi (46%) ose diplomë administratë publik (14%), megjithëse janë më së shumti fakultative me përjashtim të Italisë
- Numri i orëve si edhe i krediteve të caktuara për këto kurse ndryshojnë shumë mes vendeve (mesatarisht: 30-60 orë, 3-6 kredite)
- SNKSP-të bëjnë pjesë shprehimisht në programin mësimor në shumicën e rasteve në Itali; në Spanjë dhe Portugali, nuk bëjnë konkretisht pjesë në programin mësimor të kurseve, por standardet kombëtare të kontabilitetit janë të mbështetura në SNKSP-të

Përmbledhje dhe rrjedhojat

12

- Integrimi i KSP-së në programet e IAL-ve është përmirësuar kohët e fundit, me dhënien më shumë rëndësi KSP-së në disiplinën kontabël, por ... **ka vend për shumë përmirësim**
 - Qartësisht, mungesë e programeve studimore për MFP/KSP në dy ciklet e arsimit të lartë; planet për të ardhmen afatmesme?
 - Përfshihet numër i kufizuar studiuesish dhe studentësh; dhe shpesh SNKSP-të nuk mësohen posaçërisht – mungesë e një gjuhe të përbashkët në KSP, pra e një kontabiliteti të përbashkët me të drejta dhe detyrime të konstatuara
- KSP-ja nuk është zhvilluar ende plotësisht si degë autonome, veçmas kontabilitetit të sektorit privat – meriton të jetë **“një disiplinë më vete” (Heiling, 2020)**
- Zyrat e financës në sektorin publik rrezikojnë të mos kenë mjaftueshëm profesionistë me aftësitë e duhura, dhe u duhet të mbështeten në fuqinë punëtore ekzistuese (të mësuarit në punë, kualifikimi) ose të marrin në punë persona që janë diplomuar për juridik apo për shkencë ekonomike, pa njohuri të forta të KSP-së
- Nëpunësit e menaxhimit financiar duhet të punojnë së bashku me pedagogë për të rritur ndërgjegjësimin për nevojat e reja dhe për të nxitur dhe mbështetur mësimdhënien e duhur të KSP-së dhe menaxhimit financiar në IAL

Rasti i Portugalisë



13

- Vend evropian kontinental – shumë i centralizuar, me traditë të fortë juridike dhe model të së drejtës administrative
- Janë të detyrueshme standardet e kontabilitetit (miratuar me ligj); ndikimi i profesionit kontabël është i dobët
- Komisioni i vendosjes së standardeve të kontabilitetit – Komisioni për Standardet e Kontabilitetit të Sektorit Publik (CNCP) – <https://www.cnc.min-financas.pt/cncp.html> (i pavarur, por pranë Sekretariatit të Shtetit të Ministrisë së Financave)
- **Vendosja e standardeve – “proces me pjesëmarrje”** nga disa palë interesi në CNCP
- Standardet e kontabilitetit për sektorin publik janë të mbyllura ndaj standardeve të kontabilitetit të sektorit privat; reformat POC/POCP dhe SNC/SNC-AP (SNRF/SNSKP)
- Kontabiliteti dhe raportimi buxhetor me bazë monetare dhe me bazë angazhimesh bashkekzistojnë me kontabilitetin dhe raportimin me të drejta dhe detyrime të konstatuara prej mesit të viteve ‘90

Sistemi aktual i KSP-së – SNC-AP me tre nënsisteme



14

R
e
g
j
i
s
h
t
r
ë
i
m
i

Kontabiliteti buxhetor

Mundëson një dokumentim të hollësishëm të gjithë procesit buxhetor – BAZË MONETARE TË MODIFIKUAR, VLERË NOMINALE, KLASA 0 (menaxhimi i buxhetit kundrejt realizimit të buxhetit)

Kontabiliteti financiar

Mbështetur në SNKSP; mundëson dokumentimin e veprimeve dhe ngjarjeve të tjera që prekin pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike – BAZË ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA, KOSTO DHE VLERË TREGU, KLASAT 1 DERI 8

Kontabiliteti i drejtimit

Mundëson analizën e rezultateve të aktiviteteve dhe projekteve që kontribuojnë në efektivitetin e politikave publike dhe të përmbushjes së objektivave sa i takon ofrimit të shërbimeve për qytetarët – BAZË ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA

Komponentët e SNC-AP-së



15

- 27 NCP (regjimi i përgjithshëm) + 1 NCP (regjimi i thjeshtuar)
 - Kuadrin konceptual (kontabiliteti financiar)
 - **Plan kontabël** shumëdimensional (PCM)
-
- Raportimi individual, i konsoliduar dhe i segmenteve
 - 25 NCP të mbështetur në SNKSP; 2 standarde novatore – ***NCP 26 – Kontabiliteti dhe raportimi buxhetor dhe NCP 27 – Kontabiliteti i drejtimit***
 - Plani kontabël shumëdimensional (PCM) veprimet e kontabilitetit financiar, natyra e shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore dhe agregatet e llogarive kombëtare (raportimi “tridimensional”)... si edhe ***inventari i aktiveve***

Arsimi për kontabilitetin e sektorit publik në Portugali



16

- Formimi profesional – Instituti i Autorizuar i Kontabilistëve të Miratuar (OCC)
- Universitetet klasike dhe politeknike
- Diplomë shkencore e ciklit të parë dhe ciklit të dytë – secila njësi kursi është zakonisht 6 ECTS
- Vetëm disa kurse në nivel pasuniversitar përqendrohen në çështjet e KSP-së, shpesh bashkë me menaxhimin publik
- Njësitë e kurseve për KSP-në në përgjithësi ndjekin standardet kombëtare, sepse këto u duhen profesionistëve të ardhshëm (POCP/SNC-AP)
- Mësimdhënia e KSP-së ndjek mësimdhënien e kontabilitetit të sektorit privat – kontabiliteti dhe raportimi financiar (individual/i konsoliduar), kontabiliteti i drejtimit/i kostot, auditimi, **duke shtuar kontabilitet-raportimin buxhetor**
- Ndonjëherë, kurse të veçanta për nënsektorë – pushteti vendor, universitetet, spitalet/sektori shëndetësor
- Kontabiliteti dhe raportimi i qëndrueshmërisë nuk trajtohet ende në KSP



● Objektivat dhe rezultatet mësimore:

- Synimi është plotësimi i formimit të studentëve duke i prezantuar me konceptet dhe parimet bazë që shoqërojnë fushën financiare të njësive të sektorit publik, sidomos buxhetin dhe kontabilitetin e sektorit publik.
- Duke e futur këtë disiplinë brenda kuadrit të sektorit të administratës publike, në përgjithësi trajtohet sistemi portugez i kontabilitetit të sektorit publik (SNC-AP), me fokus të veçantë në hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave individuale (kontabiliteti dhe raportimi buxhetor dhe financiar).
- Sistemi i mbështetur në SNKSP shihet në kuadër të harmonizimit botëror dhe evropian, duke kërkuar të kuptohet si kanë çuar fazat e njëpasnjëshme të reformës së KSP-së pas viteve'90 drejt SNC-AP dhe cilat transformime ka sjellë, sidomos sa i takon ofrimit të informacioneve më të shumta dhe më të mira në mbështetje të vendimmarrjes dhe llogaridhënies në njësitë e sektorit publik në Portugali dhe, për pasojë, përmirësimin të besueshmërisë dhe transparencës së llogarive publike.

Kontabiliteti i sektorit publik në FEUC (njësi brenda masterit shkencor A&F, 30 orë, 6 ECTS) (II)



18

Struktura e programit:

1. Kontabiliteti i sektorit publik dhe i sektorit privat – kuadri i sektorit publik në Portugali
2. Reforma e kontabilitetit të sektorit publik në Portugali në kontekstin ndërkombëtar (SNKSP/SEKSP)
 - 2.1 Nga bazat e ligjit të POCP-ja
 - 2.2 Harmonizimi ndërkombëtar dhe evropian: qasja ndaj SNKSP-ve dhe SNC-AP i ri
3. Financat publike dhe kontabiliteti buxhetor
 - 3.1 Të ardhurat dhe shpenzimet publike, klasifikimet, buxheti dhe ligji organik i buxhetit
 - 3.2 Zbatimi i të ardhurave dhe shpenzimeve publike dhe ligji për angazhimet dhe detyrimet e prapambetura
 - 3.3 Kontabiliteti dhe raportimi buxhetor në SNC-AP
4. Kontabiliteti financiar në SNC-AP
 - 4.1 Kuadri konceptual
 - 4.2 Plani kontabël shumëdimensional
 - 4.3 Operacionet më të rëndësishme, të dallueshme në kontabilitetin e sektorit publik
 - 4.3.1. Të ardhurat nga veprimet me këmbim vlere dhe pa këmbim vlere
 - 4.3.2. Aktivitet afatgjata materiale dhe jo-materiale; aktivitet afatgjata material të investuara; zhvlerësimi; marrëveshjet e koncesionit (koncesion-dhënësi)
 - 4.3.3. Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivitet e kushtëzuara
 - 4.3.4. Përfitimet e punonjësve
 - 4.4 Pasqyrat individuale vjetore të njëjësive të sektorit publik – struktura dhe përmbajtja e pasqyrave financiare

Lidhur me
OZHQ 8, 16
dhe 17

Bibliografia:


- Standardet dhe manuali kombëtar
- Herë pas here, libra dhe kumtesa ndërkombëtare



Studimet në ekonomi dhe administrim biznesi për të përmbushur nevojën në rritje për profesionistë me formim biznesi dhe në veçanti në fushën e ekonomisë financiare dhe kotnabilitetit



Modernizimi dhe standardizimi i kontabilitetit në sektorin publik krijon kërkesë për profesionistë në këtë fushë



Kontabiliteti publik në programin mësimor të diplomave të ciklit të parë për ekonomi dhe administrim biznesi (Universiteti i Saragozës në 1991)

Karakteristikat e përgjithshme të kontabilitet të sektorit publik në Spanjë



- Vend kontinental evropian: traditë të fortë juridike dhe model të së drejtës administrative.
- Standardet e kontabilitetit janë të detyrueshme, ndërsa ndikimi i profesionit kontabël është shumë i dobët.
- Një organ publik nxjerr standardet e kontabilitetit shtetëror: Intervención General de la Administración del Estado (IGAE; Zyra e Kontrollorit të Përgjithshëm të Shtetit).
- Standardet e kontabilitetit për sektorin publik janë shumë të mbyllura ndaj standardeve të kontabilitetit të sektorit privat;
- Buxhet me bazë monetare të modifikuar dhe sistem me regjistrim të dyfishtë

Përshtatja e standardeve të kontabilitetit shtetëror sipas kuadrit ndërkombëtar



- E drejta tregtare dhe standardet e kontabilitetit për shoqëritë tregtare janë përshtatur sipas rregulloreve evropiane në 2007. Është miratuar një standard i ri kontabiliteti, në fuqi prej 1.1.2008

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik



- Standardet e kontabilitetit shtetëror janë përshtatur sipas standardeve spanjolle të kontabilitetit të shoqërive tregtare dhe SNKSP-ve në 2010. Zbatohen për pushtetin qendror prej 2011 dhe për pushtetin vendor prej 2015

Përshtatja e standardeve të kontabilitetit shtetëror me SNKSP-të



Raportimi i kontabilitetit shtetëror në Spanjë: Tre burime për shifrat financiare të njësive të sektorit publik



- **Buxhetor.-** Historikisht, informacione me bazë monetare sipas rregullores përkatëse
- **Financiar.-** Informacione kontabël si të shoqërive tregtare, sipas planit kontabël të sektorit publik
 - Informacion makroekonomik i agreguar
- **Llogaritë kombëtare**
 - Shifrat mikroekonomike maten sipas kriterëve ESA 2010 (për çdo njësi ekonomike publike) si përmbushja e treguesit bazë të BE-së për deficitin dhe borxhin
 - Informacion makroekonomik i agreguar

Pergatitja per kontabilitetin e sektorit publik ne universitetet spanjolle



24

- Programet e ciklit të parë:

- Diplomë në administrim dhe administratë publike: KSP është lëndë e detyrueshme
 - 21 universitete kanë studime për administrim dhe administratë publike
- Diplomë në shkenca ekonomike, administrim biznesi, kontabilitet dhe financë

- Programet e ciklit të dytë

- Master në auditim: dallime mes universiteteve
- Master në kontabilitet dhe financë: dallime mes universiteteve

- Doktoratë dhe kërkim shkencor

- Kërkimi shkencor në KSP është një fushë e rëndësishme në disa universitete spanjolle

Pergatitja per kontabilitetin e sektorit publik ne programet e ciklit të parë



25

Universiteti	EMËRTIMI	Administrim biznesi	Shkenca ekonomike	Kontabilitet dhe financë
Universiteti i Almerias	Kontabiliteti në sektorin publik			Fakultativ
Universiteti i Alikantes	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	NA
U. Autónoma Barcelona	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ	Fakultativ	Fakultativ
Universiteti i Kantabrias	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ		NA
Universiteti i Kastila La Manças	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	NA
Universiteti i Ekstremaduras	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	
Universiteti i Xhironës	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ	Fakultativ	Fakultativ
Universiteti i Granadës	Kontabiliteti i njësive ekonomike publike			Fakultativ
U. Jaime I of Castellón	Kontabiliteti në sektorin publik			Fakultativ
Universiteti i La Lagunas	Kontabiliteti i drejtimit në sektorin publik		Fakultativ	Fakultativ
U. L. Palmas Gran Canaria	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ		NA
Universiteti i Leonit	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	NA
Universiteti i Malagës	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	Të detyrueshme
Universiteti i Oviedos	Kontabiliteti në sektorin publik			Fakultativ
Universiteti i Pais Vaskos	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ (6)		NA
Universiteti Politeknik i Valencias	Kontabiliteti dhe administrimi në sektorin publik	Fakultativ (4,5)		NA
U. Pompeu Fabra	Kontabiliteti në sektorin publik	Fakultativ (5)	Fakultativ (5)	NA
Universiteti publik i Navarës	Kontabiliteti në sektorin publik		Fakultativ	NA
Universiteti i Valencias	Kontabiliteti për sektorin publik dhe OJF-të		Fakultativ	Të detyrueshme
Universiteti i Saragozës	Kontabiliteti i sektorit publik (disa tituj)	Fakultativ	Fakultativ	Fakultativ

Përgatitja për kontabilitetin e sektorit publik në programet e ciklit të parë: Universiteti i Saragozës



26

- ✓ **DIPLOMË E CIKLIT TË PARË NË ADMINISTRIM DHE ADMINISTRATË PUBLIKE**
 - ✓ Lëndë e detyrueshme me 6 Ects

- ✓ **DIPLOMË E CIKLIT TË PARË NË SHKENCA EKONOMIKE: KONTABILITETI PËR ADMINISTRATAT E SEKTORIT PUBLIK**
 - ✓ Lëndë me zgjedhje me 6 Ects

- ✓ **DIPLOMË E CIKLIT TË PARË NË ADMINISTRIM BIZNESI: KONTABILITETI I SEKTORIT PUBLIK**
 - ✓ Lëndë me zgjedhje me 6 Ects

- ✓ **DIPLOMË E CIKLIT TË PARË NË FINANCË DHE KONTABILITET: ANALIZË EKONOMIKE DHE FINANCIARE E ADMINISTRATAVE PUBLIKE**
 - ✓ Lëndë me zgjedhje me 6 Ects

Kontabiliteti i sektorit publik në ciklin e parë të shkollës së lartë: objektivat



27

- ✓ Viti IV (i fundit) i studimeve
- ✓ Pas studimit të disa lëndëve kontabiliteti tre vitet e para të studimit, në këtë lëndë studiohen standardet spanjolle të kontabilitetit (plani kontabël i përgjithshëm i sektorit publik).
- ✓ Pra, e plotëson formimin kontabël të studentit dhe e përgatit për të punuar në një mjedis ekonomik më të gjerë se sektori i shoqërive tregtare, fjala vjen në sektorin publik, duke u dhënë mundësi të reja në tregun e punës.
- ✓ Konkretisht, ofrohet një kornizë solide brenda së cilës profesioni të zhvillojë kontabilistë të aftë për të hartuar, raportuar dhe audituar pasqyra të kontabilitetit të sektorit publik.

OZHQ-të konkrete të Agjendës 2030:

4.4 Rritja e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësitë e nevojshme për punësim, punë me dinjitet dhe nismë për sipërmarrje

16.6 Krijimi i institucioneve efektive dhe me llogaridhënie në të gjitha nivelet, që të jenë transparente dhe të japin llogari

Kontabiliteti i sektorit publik në ciklin e parë të shkollës së lartë: rezultatet mësimore



28

- ✓ Të kuptohen aspektet e ndryshme të kontabilitetit të administratës publike, që mbështetet në kontabilitetin e sektorit privat, por me aspekte të dallueshme për funksionet jofitimprurëse të këtyre njësive ekonomike.
- ✓ Kompetenca për të kuptuar dallimet kryesore mes standardeve të kontabilitetit të sektorit publik (PGCP) dhe standardeve të kontabilitetit të sektorit privat (PGC).
- ✓ Mësimi i teknologjive të reja dhe programeve kompjuterike të kontabilitetit të sektorit publik që përdoren në administratën vendore për të kuptuar si kontabilizohen operacionet në administratat publike.
- ✓ Kompetencat për matjen dhe kontabilizimin e operacioneve kryesore të buxhetit të shpenzimeve dhe buxhetit të të ardhurave të njësive ekonomike publike.
- ✓ Të kuptuarit e dallimeve kryesore në matjen dhe raportimin e aktiveve afatgjata materiale dhe të detyrimeve, në krahasim me shoqëritë private.
- ✓ Kompetencat për përgatitjen dhe analizën e pasqyrave financiare të administratave publike.
- ✓ Të kuptuarit e rëndësisë së raportimit të qëndrueshmërisë dhe atij jo financiar në sektorin publik

Kontabiliteti i sektorit publik në ciklin e parë të shkollës së lartë: programi i lëndës



29

- 1. Standardet e Kontabilitetit për Administratat Publike: Standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të kontabilitetit.**
- 2. Kontabilizimi i buxhetit të shpenzimeve: Skema e tanishme e kontabilitetit buxhetor.**
- 3. Kontabilizimi i buxhetit të të ardhurave: Skema e tanishme e kontabilitetit buxhetor.**
- 4. Kontabilizimi dhe raportimi i aktiveve afatgjata materiale**
- 5. Kontabilizimi dhe raportimi i borxhit financiar.**
- 6. Kontabilizimi i veprimeve jobuxhetore.**
- 7. Pasqyrat Financiare**
- 8. Kontabiliteti i drejtimit në sektorin publik**
- 9. Auditimi i sektorit publik**
- 10. Raportimi jo financiar në sektorin publik: raportimi i performancës dhe raportimi i qëndrueshmërisë**

Kontabiliteti i sektorit publik në ciklin e parë të shkollës së lartë: veprimtaria akademike



30

✓ Teori: 30 orë

Metodika: Analizë dhe studim i standardeve të kontabilitetit. Pjesëmarrja e studentëve nxitet me shembuj realë.

✓ Praktikë: 30 orë

Metodika: Ushtrime praktike dhe raste studimore, përdorimi i teknologjive të kontabilitetit

✓ Studim vetjak: 90 orë

Përgatitja për kontabilitetin e sektorit publik në programet e ciklit të dytë: Universiteti i Saragozës



31

- **MASTER NË KONTABILITET DHE FINANCË**
 - ✓ **Analizë ekonomike dhe administrative e biznesit dhe administratave publike, lëndë e detyrueshme, 6 ECTS**
- ✓ **MASTER NË BASHKIMIN EUROPIAN**
 - ✓ **Kontabiliteti publik dhe buxhetor i Bashkimit Evropian, fakultative, 3 ECTS**
- ✓ **MASTER NË SOCIOLOGJINË E POLITIKAVE PUBLIKE DHE SOCIALE**
 - ✓ **Përgjegjësia sociale e biznesit: raportimi dhe auditimi i organizatave, fakultateve, 4 ECTS**
- ✓ **MASTER NË AUDITIM**
 - ✓ **Kontabiliteti financiar (moduli i kontabilitetit në sektorin publik)**

Kriteret e kontabilitetit të sektorit publik për kontabilistët dhe audituesit e miratuar të autorizuar



32

- Kontabiliteti i sektorit publik nuk është i detyrueshëm për audituesit e autorizuar në Spanjë.
- Auditimet e administratave të sektorit publik kryhen vetëm nga auditues të sektorit publik (nëpunës civilë).
- Kontabiliteti i sektorit publik përfshihet në kërkesat për kontabilistët e miratuar të autorizuar, një kualifikim i ri i krijuar së fundmi, por hë për hë nuk ka detyrim për të qenë kontabilist.



Faleminderit!




CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform



Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO
